



Albanian Society for the Study of English

Çështje me interes

Konferenca e dytë e ASSE-s

Lajme nga ESSE

Kuotizacionet për 2013

Thirrje të reja për *in esse*

Cfps

Përshëndetja për këtë numër

Të dashur miq!

Në radhë të parë dëshiroj që ky fundviti akademik të mbyllet me sa më shumë sukses për të gjithë ju.



Ky vit për ASSE-n ka qenë viti i aktiviteteve, ndër të cilat më i rëndësishmi ishte konferenca e dytë e ASSE-s, e cila u organizua në bashkëpunim me Canadian Institute of Technology në Tiranë në datat 2-4 maj 2013. Me këtë rast dëshiroj të shpreh falënderimet e mia të veçanta për këtë institucion si dhe për kolegun Artur Jaupaj, i cili e mundësoi këtë bashkëpunim kaq të frytshëm.

Po ashtu ASSE ka pranuar bashkëpunime me institucione të tjera jashtë vendit për organizimin e konferencave të tjera si me Universitetin e Krajavës dhe atë të Piteshtit në Rumani.

Ndërkohë ASSE vazhdon aktivitetin e saj botues të përvitshëm të numrave të radhës të *in esse: English Studies in Albania*. Numrat e 2012 pritet të dalin shumë shpejt nga botimi.

Me këtë rast, ftoj të gjithë anëtarët e ASSE-s të sjellin ide për thirrjet e reja të numrave për vitin 2014 që t'i publikojmë sa më parë me qëllim që të marrim propozime sa më interesante.

Duke ju uruar një verë të mbarë!

Me respekt,
Armela

Në këtë numër:

Konferenca e dytë e ASSE-s

Përshëndetja	1
Konferenca e dytë e ASSE-s	2
Lajme nga ESSE	3
Kuotizacionet për 2013	4
Anëtarësimet e reja	4
<i>in esse: English Studies in Albania</i>	5
Thirrje të reja për <i>in esse</i>	5
Cfps	6



Është shumë e rëndësishme që tradita e mirë e nisur nga ASSE vazhdon me një aktivitet të tillë mjaft të suksesshëm, duke formësuar edhe më tej profilin e kësaj shoqate në një shoqatë të denjë, me kërkesa dhe standarde në fushën e kërkimit të studimeve në gjuhën angleze. Me këtë rast falënderojmë të gjithë ata kolegë që kanë qenë gjithmonë mbështetës të misionit të ASSE-s.

Tema e kësaj konference ishte “Nation, nationality, nationhood: What's in a name?”. Përfaqësimi i pjesëmarrësve në konferencë ishte shumë i larmishëm për nga kombësia, interesi dhe disiplinat kërkimore. Niveli i punimeve të paraqitura ne konference ishte mjaft i lartë, gjë që dëshmon për interesin ndaj aktiviteteve të ASSE-s, por edhe për cilësinë gjithmonë e në rritje të tyre.



Folës të ftuar në këtë konferencë ishin Prof. Gëzim Alpion nga University of Birmingham, United Kingdom dhe Prof. José Igor Prieto-Arranz nga University of the Balearic Islands, Spain. Të dy folësit paraqiten punime me shumë vlerë, të cilat mbajtën gjallë interesin e të pranishmëve në sallë.



Për më shumë informacion rreth programit të konferencës, pjesëmarrësve dhe punimeve të paraqitura, mund të na ndiqni në <http://www.assenglish.org/nation/>.

Lajme nga ESSE

ESSE organizon konferencën e saj të dymbëdhjetë në Kosice të Sllovakisë në datat 29 gusht deri më 2 shtator 2014. Format i konferencave të ESSE-s është krejt i ndryshëm nga ai i konferencave që zhvillon secila shoqatë kombëtare e studimeve në gjuhën angleze. Këto konferenca nuk kanë një temë bosht, por në vend të kësaj kanë organizime tematike në seminare, tavolina të rumbullakëta,

seanca plenare dhe nënplenare si dhe një seksion për doktorantë, i cili u paraqit si risi në konferencën e njëmbëdhjetë. Temat për seminarët dhe tavolinat e rrumbullakëta përzgjidhen nga APC-ja (Academic Programme Committee), i cili propozohet dhe zgjidhet nga bordi i ESSE-s. Pothuaj dy vjet para se të zhvillohet konferenca hidhet në qarkullim një thirrje për propozime për seminarë dhe tavolina të rrumbullakëta. Rregullat për këto propozime publikohen në faqen zyrtare të ESSE-s. Për konferencën e dymbëdhjetë afati për marrjen e këtyre propozimeve është shtyrë deri në datën **15 qershor 2013**. Pasi i shqyrton propozimet, APC-ja bën përzgjedhjen e seminarëve dhe tavolinave të rrumbullakëta në përputhje me kriteret e përcaktuara. Lista e seminarëve dhe e tavolinave të rrumbullakëta bëhet e njohur në mbledhjen e bordit të ESSE-s dhe menjëherë pas kësaj publikohet në faqen zyrtare të ESSE-s e mandej fillon marrja e propozimeve për kumtesa për çdo seminar, tavolinë të rrumbullakët etj.

Informacion më të mëtejshëm për ecurinë e këtij procesi do të gjeni në faqen zyrtare të ESSE-s, <http://www.essenglish.org/> ose në *The Messenger*, newsletter-in e ESSE-s, të cilin e përfton çdo anëtar i ESSE-s.

Kuotizacionet për 2013

Njoftohen të gjithë anëtarët e ASSE-s duhet të shlyejnë detyrimin e tyre vjetor përkundrejt shoqatës brenda periudhës qershor 2013. Duke qenë se ky është një vit konference u mendua që afati për shlyerjen e këtij detyrimi të shtyhet deri në qershor nga shkurti i çdo viti që duhet të jetë normalisht. Është mirë që detyrimet vjetore të kryhen rregullisht dhe brenda afateve të caktuara, pasi më pas jemi të detyruar të kryejmë detyrimet përkatëse pranë ESSE-s për të përftuar anëtarësimin në të.

Detajet do t'ju komunikohen të gjithë anëtarëve të ASSE-s me e-mail.

Anëtarësime të reja

Dëshirojmë t'ju kujtojmë të gjithë të interesuarve se procedurat e anëtarësimit në ASSE përcaktohen në nenet 4 dhe 5 të statutit të shoqatës. Më poshtë do të gjeni këto nene.

Neni 4 – Anëtarësimi

ASSE është shoqatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e hapur për të gjithë ata kërkues, mësimdhënës, specialistë të studimeve të gjuhës angleze që punojnë në nivelin universitar në Shqipëri. Shoqata mirëpret gjithashtu të gjithë ata kërkues, mësues e specialistë ndërkombëtarë që punojnë dhe kontribuojnë për nxitjen e këtyre studimeve në Shqipëri.

Anëtarët e shoqatës përbëhen nga dy kategori:

Anëtarët e thjeshtë me të drejta dhe detyrime të plota: këtu bëjnë pjesë të gjithë ata studiues, kërkues, mësimdhënës të gjuhës angleze që operojnë në nivelin universitar përmes aktivitetit të tyre.

Anëtarë nderi: këtu bëjnë pjesë të gjithë ata njerëz dhe personalitete me kontribute të veçanta në studimin e anglishtes në Shqipëri. Statusi i anëtarit të nderit propozohet nga Këshilli Drejtues i ASSE-s në bazë të kriterëve të përcaktuara paraprakisht dhe miratohet në Mbledhjen e Përgjithshme. Anëtarët e nderit çlirohen nga detyrimi i kuotës së anëtarësimit dhe gëzojnë të njëjtat të drejta me anëtarët e thjeshtë të ASSE-s.

Neni 5 – Procedura e anëtarësimit

Çdokush me interesa profesionale e shkencore në studimet angleze që punon në nivelin universitar mund të aplikojë për tu anëtarësuar në ASSE. Për tu anëtarësuar, personat që dëshirojnë të bëjnë pjesë në ASSE duhet fillimisht të plotësojnë një formular elektronik, i cili përmban pyetje që verifikojnë statusin e aplikantit dhe provojnë njohjen e tij me statutin e ASSE-s. Të drejtën për miratimin e aplikimeve për anëtarësim e ka Këshilli Drejtues. Pas anëtarësimit, këta persona duhet të paguajnë kuotën vjetore të anëtarësimit dhe të regjistrohen në listën e anëtarëve. Përjashtohen nga kuota e anëtarësimit anëtarët e nderit të shoqatës.

in esse: English Studies in Albania

Buletini i përvitshëm i ASSE-s *in esse: English Studies in Albania* po ecën në një rrugë të mbarë. Janë tashmë 4 numra të botuar nga ky buletin, dy për vitin 2010 (Spring, Autumn) dhe dy për vitin 2011 (Spring, Autumn), me punime nga konferenca e parë e ASSE-s. Ndërkohë pritet të dalin numrat e 2012. Kujtojmë se numrat e 2013 do të kenë punimet e konferencës së dytë të ASSE-s.

Të dhënat për numrat e botuar të *in esse: English Studies in Albania* si dhe thirrjet e reja për dorëzim artikujsh do t'i gjeni në faqen <http://www.assenglish.org/publications/>.

Ftesë për ide për thirrje të reja për *in esse: English Studies in Albania* (Spring, Autumun 2014)

Të dashur miq!

Është koha që të bëjmë planifikimin për thirrjet e reja për buletin e ASSE-s. Me këtë rast ftoj të gjithë anëtarët që të sjellin idetë e tyre të shtjelluara në një paragraf (rreth 200-250 fjalë) për të përzgjedhur ato ide që duken më interesante për dy numrat e 2014 *in esse: English Studies in Albania*.

Të gjitha propozimet do të nisen në dokument Word në adresën armelap@assenglish.org. Pas afatit të dorëzimit të propozimeve, ato do të shqyrtohen nga bordi, i cili do të marrë vendimin se cilat propozime do të zhvillohen në thirrje për artikuj për numrat e 2014.

Afati i ri dorëzimit të propozimeve: 15 korrik 2013.

Afati i ri për shqyrtimin e propozimeve: 30 korrik 2013.

Call for Papers

The Department of English Language and Literature
Faculty of Letters,
“Babes-Bolyai” University, Cluj-Napoca (Romania)

announces the 7th edition of its biennial conference

Constructions of Identity - Contemporary Challenges

(Cluj-Napoca, 24-26 October 2013)

This conference's main goal is to examine the challenges and the future of English and American Studies along three major directions: Literary Studies, Language Studies, and Cultural Studies, at the beginning of the 21st century, in the era of digitalization and globalization.

More specifically, we invite presentations in the fields listed below:

- **Literary studies:**
- **British and Commonwealth literature**
- **American literature**
- **Literary theory**
- **Language studies:**
- **Language studies:**
- **Theoretical linguistics**
- **Applied linguistics: ELT**
- **Applied linguistics:**
- **Translation studies**
- **Cultural studies:**
- **Literature and culture**
- **Gender and ethnicity**
- **Film and media**

The conference will host keynote speeches and workshops. The participants in the workshops are allotted a 30-minute slot for presentation and discussion.

The general conference fee is 250 lei (about 60 €), to be paid upon arrival. This includes: participation costs, coffee breaks, lunches on Thursday and Friday, the conference dinner on Thursday and the publication in the conference volume.

For details and registration, please visit the conference website:

constructionsofidentity7.wordpress.com .

Abstracts of about 100 words should be submitted by **September 1, 2013**.

For additional information, please contact:

Dr. Adrian Radu adrian.radu@ubbcluj.ro

Dr. Petronia Petrar petronia.petrar@gmail.com.
